

12 maj 2005
UNMIK/REG/2005/25

RREGULLORE NR. 2005/25

PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI GAZETËN ZYRTARE TË MIRATUAR
NGA KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin mbi Gazetën Zyrtare, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2004,

Duke konstatuar se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo pushtetin dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi Gazetën zyrtare (Ligji nr. 2004/47) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit, me kusht që:

- (a) Termi “Gazeta zyrtare e Kosovës” kudo që paraqitet në tekstin e Ligjit të ndryshohet në “Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve të Kosovës”;
- (b) Neni 2.1 të ndryshohet në “teksti zyrtar dhe përfundimtar i ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm” dhe

- (c) Neni 3.2 të ndryshohet në “në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet versioneve të dokumenteve të ndryshme të shpallura në Gazetën zyrtare të IPVQ-ve të Kosovës, versionet në gjuhët zyrtare të Qeverisë në përputhje me paragrafin 9.3.19 të Kornizës Kushtetuese janë njësor autentike”.

Këto ndryshime paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 12 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm